

ZGJEDHJA E PRESIDENTIT NGA POPULLI: NEVOJË E KOHËS APO RETORIKË E ZAKONSHME?

KRAHASIMI I MODELEVE DHE MATJA E OPINIONIT TË
QYTETARËVE

(PUNIM DISKUTUES)

KORRIK 2015, PRISHTINË.



ZGJEDHJA E PRESIDENTIT NGA POPULLI: NEVOJË E KOHËS APO RETORIKË E ZAKONSHME?

KRAHASIMI I MODELEVE DHE MATJA E OPINIONIT TË QYTETARËVE
(PUNIM DISKUTUES)

|||||

COPYRIGHT © 2015. Kosova Democratic Institute (KDI).

Përgatitur nga: Albert Krasniqi

Redaktuar nga: Valmir Ismaili

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

|||||

PËRMBAJTJA

1. HYRJE, 3
 - 1.1. Metodologjia, 3
 2. ZGJEDHJA E PRESIDENTIT NË KOSOVË, 5
 - 2.1. Historiku i zgjedhjes së Presidentëve, 5
 - 2.2. Kompetencat e Presidentit të Republikë së Kosovës, 8
 - 2.3. Iniciativat për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, 8
 - a. Marrëveshja ndërmjet tre liderëve partiak shndërrohet në Rezolutë të Kuvendit, 8
 - b. Komisioni ad-hoc për ndryshimet Kushtetuese dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, 9
 - c. Procedurat e parapara për zgjedhjen e presidentit drejtpërdrejt nga populli, 10
 - 2.4. Marrëveshja PDK – LDK për zgjedhjen e Presidentit, 12
 3. ZGJEDHJA E PRESIDENTËVE NË EVROPË, 16
 - 3.1. Sistemet zgjedhore për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit, 17
 - a. I pari merr postin (FPTP), 18
 - b. Sistemi dy raundesh (TRS), 18
 - c. Vota e vetme e transferueshme (STV), 18
 - 3.2. Kriteret për kandidaturë, 20
 - 3.3. Kompetencat, 20
 - 3.4. Ushtrimi i Detyrës së Presidentit, 22
 - 3.5. Kufizimi i mandatit, 23
 - 3.6. Pjesëmarrja në zgjedhje, 24
 - 3.7. Përparësitë dhe mangësisë, 25
 4. REZULTATET E ANKETËS ME QYTETARË PËR MËNYRËN E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT NË KOSOVË, 27
 - 4.1. Preferencat e qytetarëve për mënyrën e zgjedhjes së Presidentit, 27
 - 4.2. Pjesëmarrja në zgjedhje, 27
 - 4.3. Preferencat për Presidentin e ardhshëm, 28
- SHTOJCA A: KOMPETENCAT E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË NDARA SIPAS FUSHAVE, 30
- SHTOJCA B: KRAHASIMI I ZGJEDHJES DHE KOMPETENCAT E PRESIDENTËVE NË SISTEMET PARLAMENTARE, 32
5. BIBLIOGRAFIA, 38

1. HYRJE

Sistemi zgjedhor në Kosovë është projektuar nga bashkësia ndërkombëtare me fare pak rol të vendorëve. Qëllim fillestar i sistemit ishte të mbrohen dhe të avancohen të drejtat e komuniteteve, përmes dhënies së rolit të rëndësishëm për ndryshimet kushtetues dhe vendeve të rezervuara, si dhe të sigurohet pjesëmarrje më e madhe e grave në politik-bërje përmes futjes së kuotës gjinore. Ndryshimet që kanë ndodhur në ndërkohë në sistemin zgjedhor ku vendorët kanë pasur rol më të madh, nuk është marrë parasysh vullneti i qytetarëve, e për më tepër kanë qenë edhe të pa informuar për ndryshimet që po bëheshin. Debati për zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit në Kosovë asnjëherë nuk është zhvilluar në mënyrë të strukturuar. Iniciativat që janë marrë, qoftë ato institucionale apo të individëve më shumë kanë qenë reaktive, sa për të tejkaluar situatat e krijuara nga krizat politike.

Ekziston bindja se me zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit duhet rritur edhe kompetencat, sepse përndryshe është i pakuptim mundi dhe shpenzimet që shkaktohen për organizimin e zgjedhjeve. Gjithashtu mendohet se me ndryshimin e modelit, nga parlamenti te populli, ndryshohet edhe sistemi parlamentar në atë presidencial apo gjysmë-presidencial. Ky punim ka për qëllim të qartësoj këto dilema përmes krahasimit të praktikave në vendet tjera.

Punimi në mënyrë kronologjike analizon proceset politike dhe procedurat e zgjedhjes së presidentëve që nga pas-lufta në Kosovë. Rezultatet e punës së komisionit për ndryshimet kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit, dhe zbërthen procedurat e parapara në Draft-ligjin për Zgjedhjet Presidenciale përfshirë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Pjesa vijuese është përqendruar në krahasimin e kompetencave dhe mënyrës së zgjedhjes së presidentëve në vendet me sistem parlamentar të qeverisjes, me fokus në vendet e rajonit, mandatet dhe kriteret e kandidimit. Ndërsa, në pjesën e fundit të punimit janë interpretuar të dhënat e anketës së zhvilluar me qytetarë në lidhje me preferencat tyre për mënyrën e zgjedhjes së presidentit në Kosovë.

1.1. METODOLOGJIA

Në këtë punim është shqyrtuar literatura përkatëse për sistemet zgjedhore, janë krahasuar kompetencat e presidentëve dhe mandati i tyre në 27 kushtetuta të vendeve të ndryshme, ligje dhe standarde ndërkombëtare. Të dhënat e analizuara janë grumbulluar në një bazë të të dhënave që më pas kanë shërbyer për krahasim. Për të kuptuar më mirë preferencat e qytetarëve është kontraktuar një kompani profesionale (UBO Consulting) për të kryer matjen e opinionit publik. Anketim i opinionit publik është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar të rëndomtë”, ku popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që njihen si shtresa – bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtareve të këtyre shtresave. Shtresimi i parë është bërë në bazë të përkatësisë etnike, shtresimi i dytë është bërë në bazë të vendbanimeve (urbane dhe rurale), si dhe shtresimi i tretë është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pikë fillestare). Pikat fillestare në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastit. Hulumtimi është

zhvilluar në teren nga data 26 qershor deri më 6 korrik 2015. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit $\pm 3.1\%$. Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1000 qytetarë të Kosovës, të moshës mbi 18 vjeç: shqiptarë (750), serb (150) dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera (100). Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë.

Është kërkuar edhe mendimi i ekspertëve dhe përfaqësuesve të partive politike, duke ditur që kjo temë nuk është trajtuar më gjerësisht në Kosovë. Konsultimet me ekspertë u përqendruan në përparësitë dhe mangësitë e zgjedhjes së drejtpërdrejt, kurse me përfaqësuesit e subjekteve politike është diskutuar lidhur me qëndrimet e tyre karshi kësaj mënyre të zgjedhjes.

Pas paraqitjes së draftit të parë të punimit është organizuar një takim diskutues. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të partive politike, ekspertë të çështjeve ligjore dhe kushtetuese, hulumtues të politikave publike dhe organizata të shoqërisë civile. Komentet dhe sugjerimet e marra gjatë takimit janë analizuar dhe adresuar në punim.

2. ZGJEDHJA E PRESIDENTIT NË KOSOVË

2.1. HISTORIKU I ZGJEDHJES SË PRESIDENTËVE

Që nga zgjedhjet e para parlamentare të pas-luftës (2001) e deri më tani, Kosova ka pasur katër presidentë. Zgjedhja e tyre është shoqëruar me kriza institucionale dhe pazare të shumta politike, kurse për përfundimin e mandatit të dy prej tyre është ‘përkujdesur’ Gjykata Kushtetuese, aktgjykimet e së cilës mbesin të debatuar edhe sot.

Fillimisht Kosova ka qenë nën administrimin e përkohshme ndërkombëtare dhe në fuqi ishte Korniza Kushtetuese. Kryetari i Kosovës kishte kompetenca të kufizuara dhe ushtrimin e funksionit duhet ta bënte në koordinim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)¹. Emërimi i Kryetarit të Kosovës kërkonte mbështetjen e partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend ose që ka të paktën 25 deputetë. Zgjedhjen e Kryetarit e bënte Kuvendi me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave të deputetëve. Nëse pas dy rundeve të votimit nuk mund të arrihej shumica e dy të tretave, në votimin e tretë kërkohesh shumica e votave e të gjithë deputetëve. Mandati i Kryetarit zgjaste vetëm tri vite, ndërsa përveç mundësisë së dorëheqjes, pushimi i funksionit ka mundur të bëhet edhe përmes shkarkimit me votat e jo më pak se 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Edhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 dhe aprovimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, zgjedhja e Presidentit ka vazhduar të bëhet nga Kuvendi. Secili shtetas i Kosovës që ka mbushur moshën 35 vjeçare dhe siguron mbështetjen e të paktën 30 deputetëve mund të nominohet si kandidat për president². Presidenti zgjedhet përmes votimit të fshehtë me votat e dy 2/3 të të gjithë deputetëve në Kuvend. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej 2/3 në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë, dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve zgjedhet President i Republikës së Kosovës.³ Mandati i Presidentit zgjatë pesë vite, dhe mund të ri-zgjedhet vetëm edhe për një herë.

Votimi i parë për President të Kosovës është kryer në dhjetor të vitit 2001, me të vetmin kandidat, kryetarin e LDK-së Ibrahim Rugova. Pas dështimit që kryetari i Kosovës të zgjidhet në raundin e parë, meqë nuk u arrit që t’i merr votat e 2/3 të deputetëve, votimi i dytë u realizua pas një muaji me 10 janar 2002, ku i njëjti përsëri nuk arriti që të zgjidhej. Duke parë se Presidenti i Kosovës nuk mund të zgjidhej as në votimin tretë, edhe pse nevojiteshin vetëm shumica e votave të deputetëve, LDK hyri në koalicion me PDK-në dhe AAK-në, duke ruajtur për vete postin e Presidentit të vendit. Më 4 mars 2002 Kuvendi i Kosovës zgjodhi Ibrahim Rugovën për President të Kosovës, votimi për të cilin u bë në pako me Kryeministrin dhe kabinetin qeveritar⁴.

Pas zgjedhjeve të dyta parlamentare, Kuvendi i Kosovës në seancën konstituive të mbajtur më

¹ Korniza Kushtetues për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Kosovës, Kreu 9.2.1.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 86.3.

³ Po aty, Neni 86.5.

⁴ Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë. (2013). *Instituti Demokratik i Kosovës*. Prishtinë: Forumi 2015.

B. KOMISIONI AD-HOC PËR NDRYSHIMET KUSHTETUESE DHE AKTGJYKIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Më 22 prill 2011, Kuvendi nxori vendimin për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës (Komisioni), si dhe hartimin e Draft-ligjit për Zgjedhjet Presidenciale¹⁶. Për më shumë se nëntë muaj komisioni nuk arriti të përfundoj obligimet e marra përsipër, për çka iu dhanë tre muaj kohë shtesë.

Më 20 mars 2012, Komisioni dorëzoi propozimet për ndryshimet kushtetuese në lidhje me mënyrën e zgjedhjes së presidentit, kurse më 23 mars Kryetari i Kuvendit dorëzoi për shqyrtim pakon kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Më 4 maj 2012, një pako e re e ndryshimeve kushtetuese është paraqitur nga 30 deputetë në Gjykatën Kushtetuese. Ndryshimet trajtojnë fuqinë e presidentit të emërojë dhe të kthejë kandidatët për postin e Drejtorit të Agjencisë për Inteligjencë, Avokatit të Popullit dhe të drejtën e vetos së në lidhje me miratimin e ligjeve. Kuvendi mund të mbivotojë (refuzojë) veton e presidentit ndaj një ligji të miratuar me shumicën e votave të të gjithë deputetëve plus dhjetë për qind vota të tjera shtesë dhe ai ligj konsiderohet i shpallur. Janë reduktuar kompetencat e presidentit në udhëheqjen e politikës së jashtme, pasi duhet të bashkëpunojë me Qeverinë në këtë dikaster, si dhe themelimin e misioneve diplomatike dhe konsullore e bënë pas propozimit të Qeverisë.

Opinionin i plotë i Gjykatës është lëshuar më 20 korrik 2012, ku arriti në përfundimin se shumica e dispozitave të amendamenteve kushtetuese nuk i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, megjithatë tetë amendamente janë konsideruar se kufizojnë këto të drejta dhe për këtë arsye nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Amendamentet e propozuara në vijim që konsiderohet që pakësojnë të drejtat e njeriut:


1. Në lidhje me kufizimin e të drejtës për të qenë kandidat për President vetëm për qytetarët që kanë qenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për pesë vjet;
2. Në lidhje me propozimet për postin e Presidentit të Kosovës - sepse ka të bëjë vetëm me subjektet politike parlamentare që e kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit;
3. Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtresit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme;
4. Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtresit të Detyrës së Presidentit për emërimin e gjyqtareve dhe prokuroreve;
5. Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtresit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e faljeve;
6. Në lidhje me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të rregullta;
7. Në lidhje me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
8. Në lidhje me ndërprerjen e parakohshme të mandatit Presidentit të Republikës së Kosovës.

¹⁶ U mbajt mbledhja konstituive e Komisionit për Ndryshime Kushtetuese. *Kuvendi i Republikës së Kosovës*. Qasur më 25 maj 2015, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1.128.3689>

C. PROCEDURAT E PARAPARA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT DREJTPËRDREJT NGA POPULLI

Në mars 2012, Komisioni për ndryshimet kushtetuese arriti të përfundoj Draft-Ligjin mbi Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Ky draft-ligj ka për qëllim të rregulloj zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit, nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve deri në dhënien e betimit. Më poshtë janë zërthyer procedurat e zgjedhjes së presidentit të parapara me draft-ligji:

Grafiku 2: Kalendari i zgjedhjeve presidenciale 2016 – në rast të zgjedhjes së drejtpërdrejt



Burimi: Draft-Ligji mbi Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës

Data e shpalljes së zgjedhjeve - Draft-ligji parasheh që Kryetari i Kuvendit të shpallë ditën e zgjedhjeve presidenciale, gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të presidentit. Rrethi i parë i zgjedhjes duhet të mbahet jo më vonë se 60 ditë para përfundimit të mandatit të rregullt të presidentit, si dhe nëse është e nevojshme të ketë rreth të dytë, duhet të mbahet jo më vonë se 21 ditë pas rrethit të parë të zgjedhjeve.

Kualifikimet e kandidatëve - Të gjithë shtetasit e Kosovës mund të kualifikohen që të certifikohen si kandidat për president nëse në momentin e kandidimit i kanë së paku 35 vjet.

Të gjithë shtetasit që plotësojnë kushtet, mund të kandidohen si kandidat për president përmes këtyre tri mënyrave:

- i. Nga subjektet e ligjshme politike të regjistruara në Kosovë;
- ii. Nga subjektet që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend; apo

- iii. Përmes dorëzimi të një peticioni në KQZ që përmban së paku 15,000 nënshkrime të qytetarëve me të drejtë vote.

Mbledhja e nënshkrimeve fillon vetëm pas shpalljes së zgjedhjeve. Qytetari me të drejtë vote mund të mbështesë kandidaturën e vetëm një kandidati për President duke nënshkruar vetëm një peticion për kandidim. Formulari për kandidaturën e kandidatëve dorëzohet në KQZ jo më vonë se 70 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Rregullat e **fushatës zgjedhore** vlejnë ato të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe kohëzgjatja (që është 30 ditë), kurse fondet për financimin e fushatës mund të mbledhen që nga dita kur fillon procedura e kandidimit. Asnjë kandidat nuk mund të shpenzojë më shumë se 0.001% e shumë së buxhetit të Kosovës për veprimtaritë e fushatës zgjedhore.

Zgjedhja e presidentit bëhet nëse kandidati merr më shumë se 50% të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme. Nëse asnjë kandidat nuk fiton më shumë se 50% të votave të përgjithshme, atëherë mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve me dy kandidatët që marrin numrin më të madh të votave nga rrethi i parë.

Betimi i presidentit bëhet paradite në ora 11:00 në ditën kur përfundon mandati i Presidentit në largim. Presidenti jep betimin para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në kryeqytetin e Kosovës.

Mandati i presidenti zgjatë 5 vjet dhe fillon në momentin e dhënies së betimit. Presidenti mund të ri-zgjedhet vetëm edhe për një mandat. Certifikimi i rezultateve përfundimtare bëhet jo më vonë se dhjetë ditë para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit.

Sipas amendamenteve kushtetuese të propozuara, **përfundimi i mandatit të Presidentit** bëhet nëse:

1. Jep dorëheqje përmes dorëzimit të letër dorëheqjes të Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Dorëheqja është e vlefshme në momentin e pranimit të letër dorëheqjes nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe është e përvokueshme.
2. Konsiliumi i Mjekëve konstaton se presidenti nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë më të gjatë se 6 muaj, Kuvendi, me votën e 2/3 e të gjithë deputetëve, e shpall vakant postin e Presidentit.

Kurse, **shkarkimi i presidentit** bëhet nëse dënohet për kryerjen e krimit të rëndë gjatë ushtrimit të detyrës, ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, ose nëse kryen akt të tradhtisë ndaj shtetit. Për këto raste, procedura për shkarkimin e Presidentit, mund të fillohet nga 1/3 e deputetëve të Kuvendit ose nga 30,000 qytetarë me të drejtë vote. Para se të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim, peticioni duhet të miratohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Për tu konsideruar Presidenti i shkarkuar, duhen votat e së paku shtatë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Zgjedhja e Presidentit nga populli bartë në vete edhe **kosto financiare** që i ngarkohet buxhetit

Ndryshimet kushtetuese që përfshijnë edhe përcaktimin e modelit për zgjedhjen e presidentit kërkojnë 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, përfshirë edhe 2/3 e votave të deputetëve nga pakicat kombëtare që mbajnë ulëse të garantuara. Në anën tjetër, fuqia numerike e partive opozitare të përfaqësuar në kuvend është e vogël dhe shpeshherë shpërfillëse nga partitë qeveritare. Kreu i PDK-së, përkundër që ka potencuar nevojën e angazhimit të të gjitha partive parlamentare në këtë proces, është treguar shpërfillës ndaj opozitës duke llogaritur në të gjitha votat e koalicionit aktual qeverisës që sipas tij ‘ka fuqinë që t’i shtyjë përpara të gjitha proceset që janë të rëndësishme për tërë vendin’²⁹. Sidoqoftë, tani për tani, partitë opozitare janë kundër zgjedhjes së drejtpërdrejtë të presidentit³⁰ dhe rezervat e tyre bazohen më shumë në ‘kompetencat ekzekutive’ që mund t’i ushtroi presidenti i ardhshëm, që sipas tyre do të kalohej në sistem presidencial³¹. Lëvizja Vetëvendosje! Edhe pse organizohet sipas parimit të demokracisë direkte, është kundër këtij parimi kur vije në shprehje zgjedhja e presidentit nga populli³². Vetëvendosje preferon që presidenti të zgjedhet nga Kuvendi, pra përmes demokracisë përfaqësuese, por me shumicë të cilësuar e jo me shumicë të thjeshtë siç mund të bëhet aktualisht në raundin e tretë³³. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, është kundër ndryshimit të sistemit, që siç thonë ata, po kërkohet të bëhet për interesat e personave të caktuar³⁴. Kurse për subjektin tjetër opozitar, Nisma për Kosovë, nuk është e rëndësishme mënyra e zgjedhjes³⁵.

Tabela 1: Qëndrimet e subjekteve politike për zgjedhjen e presidentit drejtpërdrejt nga populli

Mënyra e zgjedhjes	PDK	LDK	VV	AAK	NISMA
Drejtpërdrejt	X	X			X
Kuvendi			X	X	X

Burimi: Deklarimet për media të përfaqësuesve të subjekteve politike

Në rast të ri-dizajnimit të mënyrës së zgjedhjes dhe rishikimit të kompetencave të Presidentit, asnjëherë nuk duhet menduar në emrat e përveçëm. Mënyra e zgjedhjes dhe kompetencat e presidentit duhet të përcaktohen në atë mënyrë që të funksionalizohet ky institucion dhe të ruhet boshti politik i sistemit. Kur të mendohet për ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së presidentit, duhet t’i përgjigjemi dy pyetjeve themelore:

- i. A po arrin presidenti t’i përmbush kompetencat më këtë sistem të zgjedhjes që kemi?
- ii. A e bënë institucionin e presidentit më pak partiak zgjedhja e drejtpërdrejt nga populli?

²⁹ <http://lajmi.net/thaci-po-manipulohet-me-shifrat-e-emigranteve-ilegal/>

³⁰ Gazeta Zëri. Thaçi i frikësohet votës së Kuvendit. E enjte, 21 maj 2015. Faqe 3.

³¹ <http://lajmi.net/grabovci-me-vote-te-popullit-apo-te-deputeteve-thaci-do-te-jete-president/>

³² Norë Shabani, “Demokracia e brendshme e subjekteve politike vetëm në statutet e tyre”. Koha Ditore, 9 qershor 2015, fq. 7

³³ Norë Shabani, “Demokracia e brendshme e subjekteve politike vetëm në statutet e tyre”. Koha Ditore, 9 qershor 2015, fq. 7

³⁴ Grabovci: Prej popullit a prej Kuvendit Thaçi bëhet president. *Gazeta Tribuna*. Qasur më 28 maj 2015,

<http://gazetatribuna.com/lajme/grabovci-prej-popullit-a-prej-kuvendit-thaci-behet-president/>

³⁵ Norë Shabani, “Demokracia e brendshme e subjekteve politike vetëm në statutet e tyre”. Koha Ditore, 9 qershor 2015, fq. 7

Nëse konstatohet se mënyra e zgjedhjes është problemi në funksionalizimin e kompetencave të presidentit dhe ruajtjen e paanshmërisë partiake, atëherë duhet gjetur një zgjidhje - formë tjetër funksionimi - t'i shtohen apo t'i hiqen kompetenca dhe të ndryshohet mënyra e zgjedhjes. Nëse duhet t'i shtohen kompetenca, duhet të bëhen me qëllim që t'i ndihmohet, jo për të rritur fuqinë, por për t'i mundësuar të kundërbalancoj pushtetin e kryeministrit në një mënyrë më të efektshme.

Në Kosovë, reforma zgjedhore është ri-aktualizuar ose në prag të zgjedhjeve ose pas përfundimit të zgjedhjeve, që kryesisht ka ardhur si shfajësim para anëtarësisë për rezultatet e dobëta në zgjedhje duke akuzuar sistemin zgjedhor apo mangësitë që ka ligji për zgjedhjet në përgjithësi. Madje, deklaratimet e partive politike për një president që zgjedhet nga populli më shumë konsiderohen si deklarime populiste edhe pse këtë ata qartazi nuk e preferojnë. Shumica kanë llogaritur se më mirë është që të deklarohen për diç që ju pëlqen qytetarëve se mos fitojnë ndonjë votë duke u paraqitur si reformistë³⁶. Dëshpërimi i qytetarëve me elitën politike i ka shtyrë ata të kërkojnë shpëtimin tek një super-person imagjinar, i cili do t'i zgjidh të gjitha problemet që kanë kapluar vendin. Një pritje e tillë konsiderohet naive dhe joreale pasi gjasat janë që presidenti do të zgjedhet pikërisht me vullnetin e partive dhe se gjasat se një lider i freskët mund të depërtojë nga jashtë dhe të sfidojë elitën e etabluar janë skajshmërisht të vogla.³⁷

Komisioni i Venecias - anëtare e së cilës është edhe Kosova - rekomandon që ndryshimet në sistemet zgjedhore duhet të bëhen të paktën një vit para mbajtjes së zgjedhjeve.³⁸ Në anën tjetër, për të ndodhur ndryshimet kushtetuese dhe ligjore sipas procedurave të rregullta, kërkohet një afat kohor prej të paktën dy muajve. Në rast të ndryshimit të modelit të zgjedhjes së presidentit në Kosovë, sipas procedurave të shpjeguara në Grafikon 2, duhet që të gjitha ndryshimet ligjore të hyjnë në fuqi më së largu deri në fund të muajit shtator të vitit 2015.

³⁶ Malazogu, L. dhe Kllokoqli, S. "Deforma Zgjedhore". (2013). Demokraci për Zhvillim: Prishtinë, faqe 15

³⁷ Po aty.


³⁸ Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore. (2002). Komisioni i Venecias: II.2.B

3. ZGJEDHJA E PRESIDENTËVE NË EVROPË

Kreu i shtetit është posti më i lartë kushtetues në shtetet sovraane që ka fuqinë të përfaqësoj shtetin. Në shumicën e vendeve kreu i shtetit është person fizik, por mund të përbëhet edhe nga një trupë e personave si në rastin e Zvicrës dhe të Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës. Në dy shtete tjera, posti i presidentit mbahet nga dy persona njëkohësisht: Principata e Andorrës dhe San Marino. Roli dhe funksionet e zyrës së kreut të shtetit mund të ndryshojnë nga kompetenca të pastra ceremoniale apo simbolike në kompetenca reale ekzekutive.

Në sistemet parlamentare si Gjermania apo në monarki kushtetuese si Mbretëria e Bashkuar, për shembull, presidenti dhe monarku njihen si krerë të shtetit derisa kancelari dhe kryeministri njihen si krerë të qeverisë. Zakonisht nëse kryeministri ka më shumë pushtet ekzekutiv, atëherë roli i presidentit është kryesisht ceremonial. Megjithatë, në republikat me sistem presidencial, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Brazil presidentët e tyre njihen edhe si krerë të shtetit edhe të qeverisë. Kur kushtetuta garanton pushtet më të madh ekzekutiv për presidencën, atëherë presidenti gëzon një rol më të madh në qeveri dhe roli i kryeministrit është shumë më i zbehtë.

Grafiku 3: Mënyra e zgjedhjes së Presidentit/kreut të shtetit sipas sistemeve qeverisëse



Burimi: *Burimi: Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (IDEA)*

Në mesin e rregullimeve të ndryshme të shteteve, që krijojnë sisteme të ndryshme politike, janë katër modele kryesore të krerëve të shtetit:

2. **Sistemi parlamentar**, me dy nën-lloje:
 - a. *Modeli standard*, ku kreu i shtetit, në teori, posedon kompetencat kryesore ekzekutive, por ushtrimi i këtyre kompetencave bëhet në konsultim të detyrueshëm me kreun e qeverisë.
 - b. *Modeli jo-ekzekutiv*, në të cilën kreu i shtetit nuk ka asnjë kompetencë ekzekutive, apo shumë të kufizuara, dhe kryesisht ka rol ceremonial dhe simbolik.

Mënyra e zgjedhjes së presidentit në sistemet parlamentare bëhet drejtpërdrejt nga populli, apo nga deputetët në parlament. Presidenti shërben për mandat të kufizuar kohor, me mandat që mund të zgjatë nga tre deri në shtatë vite. Në varësi të vendit, Presidenti mund të shërbej vetëm për një mandat (Malta), për dy mandate të njëpasnjëshme pa të drejtë rizgjedhje (Kroacia), apo mund të shërbej përtej mandatit të dytë nëse pushon për një mandat (Austria). Mirëpo, ka edhe vende që nuk kanë fare kufizime në mandatin e Presidentit (Italia dhe Islanda).

3. **Sistemi gjysmë-presidencial**, ku kreu i shtetit ndanë kompetencat kryesore ekzekutive me kreun e qeverisë apo kabinetin qeveritar. Zakonisht Presidenti merret me çështjet e jashtme, kurse kryeministri me ato të brendshme. Në rastet kur këto dy poste ushtrohen nga përfaqësues që vijnë nga parti politike të ndryshme njihet si kohabitacion. Mënyra e zgjedhjes së Presidentit në republikat gjysmë-presidenciale është e drejtpërdrejt nga populli dhe vlen për një mandat të kufizuar kohor.
4. **Sistemi presidencial**, ku kreu i shtetit është gjithashtu edhe kreu i qeverisë dhe ka të gjitha kompetencat ekzekutive. Mënyra e zgjedhjes së Presidentit në republikat presidenciale është e drejtpërdrejt nga populli dhe vlen për një mandat të kufizuar kohor.
5. **Monarkitë kushtetuese**, ku kreu i shtetit është monarku dhe ka kompetenca ceremoniale dhe simbolike. Mandati i tyre është i përjetshëm dhe posti trashëgohet brenda anëtarëve të së njëjtës familje. Në monarkitë kushtetuese kompetencat ekzekutive ushtrohen nga kryeministri, si kreu i qeverisë.

3.1. *SISTEMET ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJEN E DREJTPËRDREJTË TË PRESIDENTIT*

Sistemi zgjedhor për Presidentin duhet dalluar nga sistemi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare. Një vend mund të aplikoj sistem të ndryshëm zgjedhor për presidentin, kurse për zgjedhjet parlamentare të ketë sistem tjetër. Tri familjet e sistemeve zgjedhore janë sistemi mazhoritar,

përfaqësimi proporcional, si dhe sistemi i përzier që ka elemente të mazhoritarit dhe të përfaqësimit proporcional. Zgjedhja e presidentit në sistemet presidenciale dhe gjysmë-presidenciale bëhet drejtpërdrejt nga populli për shkak të kompetencave ekzekutive që gëzojnë, kurse në sistemet parlamentare zgjedhja e presidentit mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga trupi elektoral apo nga deputetët në Kuvend. Madje, rastet e zgjedhjes së presidentëve nga Kuvendi në republikat parlamentare janë më të rralla. Në sistemet parlamentare presidenti nuk mundet të ketë kompetenca ekzekutive, por vetëm ceremoniale dhe simbolike.

Për zgjedhjen e presidentit drejtpërdrejt nga trupi elektoral, aplikohet kryesisht sistemi mazhoritar me variante të ndryshme të votimit. Tri nga sistemet më të përdorura për zgjedhjen e presidentit janë:

A. I PARI MERR POSTIN (FPTP)

I pari merr postin, është forma më e thjeshtë për zgjedhjen e presidentit. Kandidati fitues është kandidati që fiton më së shumti vota në raport me kandidatët tjerë në garë, edhe në qoftë se kjo nuk është një shumicë absolute e votave të vlefshme.

Një sistem i tillë është më pak i kushtueshëm dhe më efikas, por len të hapur mundësinë që presidenti të zgjedhjet me shumë pak vota, ndërkohë që shumica e elektoratit mund të kenë votuar kundër tij³⁹.

B. SISTEMI DY RAUNDESH (TRS)

Sistemi dy raundesh është sistem mazhoritar në të cilin mbahet një raund i ri i zgjedhjeve nëse në raundin e parë të zgjedhjeve asnjë kandidat nuk arrin të fitoj shumicën absolute të votave (50 për qind plus një). Rëndom, raundi i dytë i zgjedhjeve zhvillohet në mes të dy kandidatëve që kanë fituar më së shumti vota në raundin e parë. Kandidati i cili fiton më së shumti vota në raport me kandidatin tjetër në garë shpallet fitues⁴⁰.

Sistemi dy raundesh ka kosto më të lartë financiare dhe certifikimi i rezultateve merr kohë më të gjatë, por jep mundësinë votuesve që të bëjnë përzgjedhjen në mes të dy kandidatëve më të mirë në raundin e dytë.

C. VOTA E VETME E TRANSFERUESHME (STV)


Vota e vetme e transferueshme është një sistem preferencial në të cilin votuesit përzgjedhin të preferuarit e tyre, duke bërë radhitjen e të gjithë kandidatëve sipas preferencës së tyre. Por, mund të zgjedhin vetëm njërin kandidat. Nëse njëri kandidat fiton shumicën absolute, menjëherë zgjedhet. Nëse asnjë nga kandidatët nuk arrin të fitoj shumicën absolute të votave, atëherë kandidati që ka fituar numrin më të vogël të votave eliminohet, kurse votat e tij/saj shpërndahen te kandidatët tjerë sipas preferencës së votuesit. Kështu ndodh derisa njëri nga kandidatët arrin kuotën e caktuar.

³⁹ Reynolds, A. Reilly, B. dhe Ellis A. (2008). “*Projektimi i Sistemit Zgjedhor*”. IDEA: Stokholm.

⁴⁰ Reynolds, A. Reilly, B. dhe Ellis A. (2008). “*Projektimi i Sistemit Zgjedhor*”. IDEA: Stokholm.

Vota e vetme e transferueshme aplikohet shumë pak (Irlanda është vendi i vetëm në Evropë që aplikon këtë sistem për zgjedhjen e presidentit), ngase është mjaft kompleks për tu administruar nga trupat menaxhuese të zgjedhjeve, sidomos sa i përket shpërndarjes së votave preferenciale, si dhe është më vështirë të kuptohet nga zgjedhësit.

Grafiku 4: Sistemet zgjedhore për zgjedhjen e drejtpërdrejt të Presidentit sipas vendeve



Burimi: Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (IDEA)

Siç mund të shihet edhe nga grafiku 4, vendet me sistem parlamentar në Evropë më së shumti përdorin sistemin dy raundesh për zgjedhjen e drejtpërdrejt të presidentit, përkatësisht 13 prej 16 vendeve. Sistemi dy raundesh për zgjedhjen e presidentit përdoret gjithashtu edhe nga gjashtë vendet tjera me sistem presidencial apo gjysmë-presidencial në Evropë. Dy sistemet tjera, I pari merr postin dhe Vota e vetme e transferueshme janë më pak të përdoruara, përkatësisht nga dy dhe një vend⁴¹.

⁴¹ Shih: <http://www.idea.int/esd/field.cfm?field=158®ion=50>

3.2. KRITERET PËR KANDIDATURË

Meqenëse, nga presidenti si kreu i shtetit kërkohet të përfaqësoj unitetin e popullit dhe të luaj rolin e arbitrit, që nënkupton të jetë i paanshëm, shumë vende aplikojnë kriteret e ndryshme për zgjedhjen e presidentit nga ato të deputetëve në parlament. Një prej kriterëve më të zakonshme është kriteri i moshës, që zakonisht kërkon që kandidatët të jenë të moshës 35 dhe 40 vjeçare. Në Itali kriteri i moshës për president është mosha 50 vjeçare pasi supozohet një lloj pjekurie politike, dhe duke qenë në moshë më të vjetër konsiderohet se është në mes apo në përfundim të karrierës politike dhe kështu mundohet të lënë vepra të mira në fund⁴². Kur është në zhvillim të karrierës politike mund të ketë më shumë anime për shkak të ambicieve. Por ka edhe vende si Kroacia që nuk kanë kriter më të lartë se mosha 18 vjeçare për kandidatët për president, që praktikisht mund të zgjedhjet edhe një person që nuk ka përfunduar shkollimin e lartë. Përveç kriterit të moshës, kriter i shtetësisë është i domosdoshëm, por në shumicën e shteteve kërkohet që kandidati për president të ketë jetuar në vend për një periudhë të caktuar kohore. Zakonisht kjo periudhë përfshinë 10 vitet e fundit. Në Moldavi një prej kriterëve për president është të dijë gjuhën e vendit, kurse në Turqi të ketë përfunduar shkollimin e lartë. Kriteri i mbledhjes së një numri të caktuar të nënshkrimeve për ta mbështetur kandidaturën gjithashtu aplikohet në shumicën e vendeve. Zakonisht kërkohen 10 mijë nënshkrime nga personat me të drejtë vote, apo të propozohen nga një numër i caktuar i deputetëve në Kuvend (1/3 e deputetëve).

3.3. KOMPETENCAT

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të kompetencave të presidentëve në sistemet parlamentare janë analizuar kompetencat e presidentëve të 27 vendeve, kurse më në detaje janë analizuar kompetencat e presidentëve në vendet e rajonit, në katër prej tyre (Maqedoni, Kroaci, Slloveni dhe Turqi) ku presidenti zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga populli, si dhe në dy vende (Shqipëria dhe Greqia) ku presidenti zgjedhet nga deputetët në parlament (Shih Shtojcën B).

Ajo që është e përbashkët në të gjitha rastet, dhe pavarësisht mënyrës së zgjedhjes, ka të bëjë me kompetencat e presidentit për caktimin e mandatarit për formimin e qeverisë, funksioni i komandantit suprem të forcave të armatosura pasi që ministria konsiderohet si organ politik, udhëheqja e politikës së jashtme, si dhe emërimi dhe pranimi i përfaqësuesve të huaj diplomatik në vend. Kompetenca e presidentit për të emëruar diplomatë në misione jashtë vendit e ka zanafillën nga koha e monarkive kur mbreti ka dërguar përfaqësuesit e tij në vendet tjera, kurse në kohët moderne ambasadorët përfaqësojnë presidentin⁴³. Ndarja e dekoratave dhe mirënjohjeve është kompetencë e presidentëve, kurse falja e të dënuarve në disa vende ushtrohet në konsultim me ministrinë përkatëse.

Kompetencat e presidentit të Maqedonisë dhe të Sllovenisë që zgjedhën drejtpërdrejt nga populli janë simbolike dhe mjaftë të kufizuara. Përveç kompetencave bazike që janë praktikë edhe në vendet tjera, në Maqedoni presidenti ka kompetenca edhe në fushën e gjyqësorit, që


⁴² Intervistë me Hektor Ruci, *Ligjërues i së Drejtës Publike*, Tiranë, 20 qershor 2015.

⁴³ Po aty.

3.5. KUFIZIMI I MANDATIT

Kufizimi i mandatit të presidentit është një element tjetër i rëndësishëm, që ka për qëllim shmangien e regjimeve autokratike dhe rotacionin e pushtetit. Edhe nëse nuk ka tendenca autokratike, mbajtja e një posti për kohë të gjatë konsumon udhëheqësit dhe nuk sjell energji të reja.

Grafiku 5: Mandati i Presidentëve në vendet me sistem parlamentar



Meqenëse Bosnjë dhe Hercegovina ka sistem federativ të qeverisjes, presidenca përbëhet nga një trupë prej tre personave. Presidenti, dhe dy nënpresident që vijnë nga etnitë tjera përbërës të federatës: një boshnjak dhe një kroat që zgjedhën nga Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës, dhe një serb që zgjedhet nga Republika Serbe. Së bashku shërbejnë për një mandat katër vjeçar⁵⁵. Anëtari me më shumë vota bëhet kryesues, përveç nëse ka qenë në detyrën e kryesuesit në kohën e zgjedhjeve, por kryesimi bëhet me rotacion çdo tetë muaj, për të siguruar barazi. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, sikurse në Islandë, presidenti nuk ka kufizim në mandate. Shumica e shteteve tjera që zgjedhin presidentin drejtëpërdrejt, kanë të kufizuar në pesë vite mandatin e presidentit, që mund të shërbej më së shumti për dy mandate pa të drejtë rizgjedhje. Në Finlandë dhe Austri, mandati

⁵⁵ Kushtetuta e Bosnjë dhe Hercegovinës, Neni 21, B.1

demokracia përfaqësuese. Zgjedhja e drejtpërdrejtë e rrit stabilitetin e qeverisë pasi shpërndarja e Kuvendit nuk bëhet nëse nuk zgjedhet presidenti siç parashihet në rastet kur zgjedhet nga Kuvendi. Kurse, nëse e shikojmë në anën tjetër të medaljes, nëse votojnë të gjithë në zgjedhje të drejtpërdrejtë, atëherë sundon shumica. Kjo mund të rezultojë në shtypjen e pakicave. Shpesh përqindja e pakicave apo femrave deputete nuk korrespondon me demografinë e popullsisë. Në zgjedhje të drejtpërdrejtë popullore, një kandidat teorikisht mund të fitojë pa pasur mbështetje të gjerë në të gjithë vendin. Për shembull, nëse një kandidat ka qenë shumë popullor në komuna të mëdha, nuk ka nevojë për të fituar vota nga komunat tjera të vendit. Zgjedhja e një presidenti që nuk ka përkrahje të gjerë rajonale, mund të çojë në një vend të ndarë dhe më pak koheziv. Biznesmenët dhe personat e tjerë të pasur janë më të favorizuar, pasi mund të përballojnë koston e fushatës. Në demokracitë e reja dhe jo mirë të konsoliduara rriten tendencat për autoritarizëm.

Pavarësisht mënyrës së zgjedhjes, sfiduese mbetet që institucioni i presidentit të bëhet sa më pak partiak. Më shumë se mënyra e zgjedhjes ka rëndësi se kush e propozon kandidatin për president. As në zgjedhje të drejtpërdrejta nuk ka kandidat konsensual, nëse ata/ato kandidohen nga partitë dhe mbështeten nga to gjatë fushatës zgjedhore. Presidenti mund të ndihet borxhli ndaj partisë që e ka mbështetur⁵⁷.

⁵⁷ Intervistë më Hektor Ruci, *Ligjërues i së Drejtës Publike*, Tiranë, 20 qershor 2015.

4. REZULTATET E ANKETËS ME QYTETARË PËR MËNYRËN E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT NË KOSOVË

Nisur nga fakti se mandati i Presidentes aktuale do të përfundoj në prill të vitit 2016, dhe në mes të partnerëve të koalicionit aktual qeverisës PDK dhe LDK ekziston një marrëveshje që përfshin edhe postin e Presidentit, kurse në anën tjetër jasnë shtuar deklarime se mënyra e zgjedhjes së Presidentit duhet të ndryshohet për të kaluar në zgjedhje të drejtpërdrejt nga populli, ne kemi zhvilluar edhe një anketë me qytetarët për të kuptuar më mirë preferencat e tyre për këto tema.

Anketa është zhvilluar me 1,000 respondent, prej tyre 51.35 për qind ishin burra, dhe 48.65 për qind ishin gra. Margjina e gabimit, siç është përmenduar edhe në metodologjin të këtij punimi, është +3.1 për qind. Meqenëse ky punim është diskutues, ne nuk do t'i analizojmë rezultatet e anketës por vetëm do t'i paraqesim ato.

4.1. PREFERENCAT E QYTETARËVE PËR MËNYRËN E ZGJEDHJES SË PRESIDENTIT

Në pyetjen lidhur me preferencat e qytetarëve për mënyrën e zgjedhjes së Presidentit, 89.7 për qind e të anketuarëve janë shprehur të favor të zgjedhjes së drejtpërdrejt të Presidentit nga populli, kurse vetëm 10.3 për qind janë deklaruar se duhet ruajtur sistemin aktual të zgjedhjes që është nga Kuvendi.


Cilin sistem të zgjedhjes së Presidentit preferoni:



4.2. PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE

Sa i përket pjesëmarrjes në zgjedhje në rast të zgjedhjes së drejtpërdrejt të Presidentit nga populli, 84.8% janë deklaruar se do të merrnin pjesë në zgjedhje, që është pjesëmarrje më e lartë se ajo zyrtare në zgjedhjet e fundit parlamentare 42.63 për qind. Kurse, vetëm 4.3 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se nuk do të marrin pjesë në zgjedhje. Votuesit që nuk e dinë nëse do të merrnin pjesë në zgjedhjet presidenciale janë 10.9 për qind.

**Në rast të zgjedhjes së drejtpërdrejtë të Presidentit,
a do të merrnit pjesë në zgjedhje?**




4.3. PREFERENCAT PËR PRESIDENTIN E ARDHSHËM

Pyetja e tretë drejtuar qytetarëve është lidhur me preferencat e tyre për personin që do të dëshironin ta shihnin si President të ardhshëm të vendit. Pyetja ishte e hapur dhe të anketuarit kanë qenë të lirë të shprehin preferencat e tyre. Sipas rezultateve të anketës, nuk ka një person konsensual që do të merrte shumicën e votave që nënkupton se në rast të zgjedhjeve të drejtpërdrejta dhe sipas sistemit të zgjedhjes të paraparë në Draftligjin për Zgjedhjen e Presidentit, raundit i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve më të votuar është i pashmangshëm.

Sidoqoftë, personi më i preferuar nga qytetarët e anketuar për postin e Presidentit është kryetari i PDK-s, Hashim Thaçi me 29.6 për qind, njëherë edhe kandidati i përbashkët i PDK-së dhe LDK-së për këtë post në bazë të marrëveshjes së tyre për bashkëqeverisje. Si kandidatin e dytë më të preferuar qytetarët kanë nxjerrë ish kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti me 17.1 për qind, kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj është personi i tretë më i preferuar nga qytetarët me 10.6 për qind. Përqindje prej 9.8 e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë ndonjë kandidat të preferuar, përderisa 6.9 për qind kanë thënë se do të dëshironin dikë tjetër jashtë skenës aktuale. Presidentja e tanishme e vendit Atifete Jahjaga duket se nuk gëzon mbështetje të qytetarëve edhe për mandatin e dytë, ngase vetëm 2 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se do të dëshironin një gjë të tillë.

Kush mendoni se duhet të jetë President i ardhshëm i Kosovës?



SHTOJCA A: KOMPETENCAT E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË NDARA SIPAS FUSHAVE

Sektori	Kompetencat
Punët e Jashtme	<p>(1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;</p> <p>(7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;</p> <p>(10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;</p> <p>(11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;</p> <p>(24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;</p> <p>(25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;</p>
Mbrojtja dhe Siguria	<p>(12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;</p> <p>(20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;</p> <p>(21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendës drejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelejencë;</p> <p>(22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;</p> <p>(23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;</p>
Gjyqësori dhe Legjislativi	<p>(1) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;</p> <p>(3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;</p> <p>(8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;</p> <p>(4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;</p> <p>(5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;</p> <p>(6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;</p> <p>(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;</p> <p>(14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;</p> <p>(15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;</p> <p>(16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;</p>

	<p>(17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;</p> <p>(18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;</p> <p>(19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;</p> <p>(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;</p> <p>(28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;</p> <p>(29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;</p> <p>(30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.</p>
Komunitetet	(13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
Sistemi Financiar	(27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;

Shënim: Teksti me shkronja të theksuara tregon për “konsultimet e detyrueshme” të presidentit

SHTOJCA B: KRAHASIMI I ZGJEDHJES DHE KOMPETENCAT E PRESIDENTËVE NË SISTEMET PARLAMENTARE

Shteti	Maqedonia	Kroacia	Slllovenia	Turqia	Shqipëria	Greqia
Sistemi zgjedhjes:	<p>Drejtëpërdrejt nga populli – Sistem dy raundesh.</p> <p>(Nëse është një kandidat, dhe nuk fiton shumicë e votave, përsëriten zgjedhjet).</p>	Drejtëpërdrejt nga populli – Sistem dy raundesh.	Drejtëpërdrejt nga populli – Sistem dy raundesh.	Drejtëpërdrejt nga populli – Sistem dy raundesh.	Deputetët në Kuvend - Zgjedhja në tri raundet e para me 3/5 e votave të të gjithë deputetëve. Në raundin e katërt dhe të pestë me zgjedhjet kandidati që siguron shumicën e votave të të gjithë deputetëve në Kuvend.	Deputetët në Kuvend - Për zgjedhjen në raundin e parë kërkohet shumicë e kualifikuar (2/3). Në raundin e dytë dhe të tretë kërkohen 3/5 e numrit të përgjithshëm të deputetëve.
Kriteret:	<ul style="list-style-type: none"> - Të ketë arritur moshën 40 vjeçare. - Të jetë banor i Maqedonisë së paku për 10 vjet në 15 vitet e fundit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Mosha mbi 18 vjeçare. - Të jetë shtetas. 	- Të jetë shtetas.	<ul style="list-style-type: none"> - Të ketë arritur moshën 40 vjeçare. - Të ketë përfunduar shkollimin e lartë. - Të jetë shtetas. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të ketë arritur moshën 40 vjeçare. - Të jetë shtetas dhe banor i Shqipërisë për së paku 10 vitet e fundit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të ketë arritur moshën 40 vjeçare. - Të jetë shtetas grek për të paktën 5 vite, dhe të jetë nga pasardhësit greke nga linjë e babait.
Propozimi:	10,000 nënshkrime të zgjedhësve, apo	10,000 nënshkrime të	-//-	20 nënshkrime të deputetëve.	20 nënshkrime të deputetëve.	Grupet parlamentare.

	30 të deputetëve.	zgjedhësve.				
Betimi:	Para deputetëve në parlament.	Para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese	Para deputetëve në parlament.	Para deputetëve në parlament.	Para deputetëve në parlament.	Para deputetëve në parlament.
Mandati:	Jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme pesë-vjeçare.	Jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme pesë-vjeçare.	Jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme pesë-vjeçare.	Jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme pesë-vjeçare.	Jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme pesë-vjeçare.	Jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme pesë-vjeçare.
Shkarkimi:	Gjykata Kushtetuese me 2/3 e votave të të gjithë gjyqtarëve.	Gjykata Kushtetuese me 2/3 e votave të të gjithë gjyqtarëve.	Gjykata Kushtetuese me 2/3 e votave të të gjithë gjyqtarëve.		Gjykata Kushtetuese.	Deputetët në parlament me 3/5 e numrit të përgjithshëm.
Ushtrues i detyrës:	Kryetari i Parlamentit	Kryetari i Parlamentit	Kryetari i Parlamentit	Kryetari i Parlamentit	Kryetari i Parlamentit	Kryetari i Parlamentit
Kompetencat kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> - cakton mandatarin për formimin e Qeverisë; - emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit jashtë vendit; - pranon letrat kredenciale dhe revokuese të 	<ul style="list-style-type: none"> - i beson mandatin për të formuar qeverinë për një individ i cili, bazuar në shpërndarjen e vendeve në Parlament, gëzon besimin e shumicës së të gjithë deputetëve; - sjellë vendime për emërimin e 	<ul style="list-style-type: none"> - shpall ligjet; - emëron zyrtarët e shtetit ku parashihet me ligj; - emëron dhe tërheq ambasadorët dhe të dërguarit, dhe pranon letrat kredenciale të përfaqësuesve të 	<ul style="list-style-type: none"> - shpallë ligjet, kthen ligjet në Kuvend për rishqyrtim, paraqet ligjet në referendum në lidhje amendament e Kushtetutës; - vendosur për shpalljen e zgjedhje për Kuvend; - emëron 	<ul style="list-style-type: none"> - i drejton mesazhe Kuvendit; - ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit; - jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit; - jep dekorata e tituj nderi sipas 	<ul style="list-style-type: none"> - asnjë akt i Presidentit nuk mund të jetë i vlefshëm dhe as të ekzekutohet nëse nuk ka qenë i bashknënshkrura edhe nga ministri kompetent. - me përjashtim për aktet e mëposhtme nuk do të kërkohet nënshkrimi i dytë:

	<p>përfaqësuesve të huaj diplomatikë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; - propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor; - emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri; - i propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike; - emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; - ndan dekorata dhe mirënjohje 	<p>Kryeministrit, me nënshkrimin edhe të Kryetarit të Parlamentit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - emëron një qeveri të përkohshme jo-partiake në rastet e përcaktuara me Kushtetutë; - shpërndanë Parlamentin në rastet e përcaktuara me Kushtetutë; - mund t'i propozojë Qeverisë për të mbajtur një seancë tematike që e konsideron çështje të veçantë; - mund të marrë pjesë në çdo seancë të mbajtur nga ana e Qeverisë dhe të marrin pjesë në diskutime; 	<p>huaj diplomatikë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëshon instrumentet e ratifikimit; - vendos për faljen; - jep dekorata e tituj nderi; - kryen edhe punë tjera të përcaktuara me Kushtetutë; - ku kërkohet nga Presidenti duhet të shprehë mendimin e tij mbi një çështje individuale. 	<p>Kryeministrin dhe pranon dorëheqjen e tij / saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> - emëron dhe shkarkon ministrat me propozim të Kryeministrit; - akrediton përfaqësuesit e shteteve të huaja; - ratifikon dhe shpallë traktatet ndërkombëtare; - në emër të Kuvendit përfaqëson Zyrën e Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura; - vendosë për përdorimi i Forcave të Armatosura; - thërret dhe kryeson Këshillin e Sigurimit Kombëtar; - shpall gjendjen e jashtëzakonshme; 	<p>ligjit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit; - me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare; - pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë; - lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit; - me propozim të 	<ul style="list-style-type: none"> * emërimin e Kryeministrit; * shpërbërjen e parlamentit; * kthimi në parlament të një draft-ligji të votuar apo të propozuar; - dekreti për të shpallur një referendum mbi projekt-ligjin, duhet të nënshkruhet edhe nga Kryetari i parlamentit. - presidenti, përfaqëson shtetin jashtë, mund të shpallë luftë, të lidh traktatet e paqes, aleancës, bashkëpunimit ekonomik dhe pjesëmarrjes në organizata ndërkombëtare apo sindikatave dhe do të njoftojë parlamentin me sqarimet e nevojshme.
--	---	---	--	---	--	---

	<p>në përputhje me ligjin;</p> <p>- bën faljen në përputhje me ligjin.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - i propozon Parlamentit emërimin dhe lirimin nga detyra të Shefit të Drejtësisë së Gjykatës Supreme, në pajtim me Kushtetutën; - thërret referendum në pajtim me Kushtetutën; - bënë faljen në pajtim me ligjin; - jep dekorata dhe çmime të përcaktuara me ligj; - vendos për formimin e misionëve diplomatike dhe zyrat konsullore jashtë vendit; - vendos për emërimin dhe tërheqjen nga detyra të shefave 		<ul style="list-style-type: none"> - nxjerrë dekrete që kanë fuqinë e ligjit; - nënshkruan dekretet; - zbutë dënimet e ngarkuara mbi individë të caktuar, për shkak të sëmundjes kronike, paaftësisë ose moshës së vjetër mbi 52 vjeçare; - emëron anëtarët dhe kryesuesin e Këshillit Mbikëqyrës të Shtetit; - udhëzon Këshillin Mbikëqyrës të Shtetit për të kryer hetime; - emëron anëtarët e Këshillit të Arsimit të Lartë, dhe emëron presidentin e universiteteve; - emëron anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, një të 	<p>Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit; - emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit;</p> <p>- cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve;</p> <p>- kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - presidenti emëron Kryeministrin dhe me rekomandimin e tij emëron dhe i shkarkon anëtarët e tjerë të kabinetit qeveritar. - presidenti mund të pezullojë një seancë parlamentare vetëm një herë, ose duke shtyrë fillimin e saj ose duke shtyrë atë. - presidenti do të nxjerrë dhe publikojë ligjet e miratuara nga Kuvendi brenda një muaji pas votimit. - presidenti, kthen një Ligji të miratuar nga Kuvendi, duke i paraqitur arsyet e tij për këtë kthim. - lëshimi i dekreteve të përgjithshme rregulluese, në bazë të delegimit të veçantë të dhënë nga statuti dhe
--	--	---	--	--	--	--

		<p>të misionëve diplomatike jashtë vendit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - pranon letrat kredenciale dhe letrat e tërheqjes nga krerët e misionëve të huaja diplomatike. - përfaqëson Forcat e Armatosura në vend dhe jashtë; - nxjerrë Strategji Ushtarake; - mund të shpallë luftë dhe arritjen e paqes në bazë të një vendimi nga Parlamenti; - emëron dhe shkarkon nga detyra shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe komandantët ushtarakë; 		<p>katërtën e anëtarëve të Këshillit të Shtetit, Kryeprokuroren publik dhe Zëvendës Prokuroren Publik të Gjykatës së Lartë të Apelit, anëtarët e Gjykatës së Lartë të Apelit Ushtarak, anëtarët e Gjykatës së Lartë Administrative Ushtarake dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.</p>	<p>brenda kufijve të delegimit të tillë, do të lejohen me propozimin e ministrit kompetent.</p> <ul style="list-style-type: none"> - në rrethana të jashtëzakonshme të një nevojë urgjente dhe të paparashikueshme, Presidenti mundet, me propozimin e kabinetit qeveritar, të nxjerrë aktet me përmbajtje legjislative. Aktet e tilla duhet të dorëzohet në Parlament për ratifikim. - presidenti me dekret mund të shpallë një referendum për çështje të rëndësishme kombëtare të pasuar me një rezolutë të votuar nga shumica absolute e numrit të përgjithshëm të deputetëve, me
--	--	--	--	---	--

		<p>- mund të urdhërojë punësimin e forcave të armatosura në rast të një rreziku të mundshëm ndaj pavarësisë, integritetit dhe ekzistencës së shtetit, edhe në qoftë se nuk është shpallur gjendja e luftës, bëhet me nënshkrimin e dytë të Kryeministrit.</p>			<p>propozimin e Kabinetit.</p> <p>- presidenti është komandant suprem i forcave të armatosura të vendit, komanda e të cilit do të ushtrohet nga Qeveria.</p> <p>- presidenti ka të drejtë, në bazë të rekomandimit nga Ministri i Drejtësisë dhe pas konsultimit me një këshill të përbërë me shumicën e saj prej gjyqtarëve, për të dhënë falje, apo të reduktoj dënimin e dhënë nga gjykata.</p>
--	--	---	--	--	--

Burimi: Kushtetutat dhe ligjet për zgjedhjet presidenciale në vendet përkatëse

5. BIBLIOGRAFIA

Legjislacioni:

1. Korniza Kushtetues për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Kosovës.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
3. Kushtetuta e Bosnjë dhe Hercegovinës.
4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
5. Kushtetuta e Greqisë.
6. Kushtetuta e Republikës Çeke.
7. Draftligji për Zgjedhjen e Presidentit në Kosovë.
8. Aktgjykim në Rastin Nr. KO 29/11. (30 mars 2011). Gjykatat Kushtetuese e Republikës së Kosovës.
9. Aktgjykim në Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. (20 korrik 2012). Gjykatat Kushtetuese e Republikës së Kosovës.
10. Rezolutë në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi. Legjislatura e IV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet:

1. Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë. (2013). Instituti Demokratik i Kosovës. Prishtinë: Forumi 2015.
2. Gjykatësi John R. Tuhheim, Memorandum #5 drejtuar Komisionit për Reformën Kushtetuese.
3. Gjykatësi John R. Tuhheim, Memorandum #4 drejtuar Komisionit për Reformën Kushtetuese.
4. Thompson, Wayne C. (2008). The World Today Series: Nordic, Central and Southeastern Europe. Harpers Ferry, West Virginia: Stryker-Post Publications.
5. Reynolds, A. Reilly, B. dhe Ellis, A. (2005). “Doracaku për Projektimin e Sistemit Zgjedhor”. Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore: Stokholm.

Intervista:

1. Intervistë personale me Hektor Ruci, Ligjërues i së Drejtës Publike, Tiranë, 20 qershor 2015.

Gazeta:

1. Gazeta Zëri. Thaçi i frikësohet votës së Kuvendit. E enjte, 21 maj 2015.

2. Shabani, Norë. “Demokracia e brendshme e subjekteve politike vetëm në statudet e tyre”.
Koha Ditore, 9 qershor 2015.

Dokumente nga Interneti:

1. PDK arrin marrëveshje me AKR-në, Pacolli President. Ekonomia. Qasur më 20 maj 2015,
<http://www.ekonomia-ks.com/?page=1,20,11266>
2. Gjykata kushtetuese: Zgjedhja e Pacollit jo kushtetuese. DW. Qasur më 21 maj 2015,
<http://www.dw.de/gjykata-kushtetuese-zgjedhja-e-pacollit-jo-kushtetuese/a-14951079>
3. Kosovë, arrihet marrëveshja për tejkalimin e krizës, ABC News. Qasur më 20 maj 2015,
<http://www.abcnews.al/lajme/rajoni/7/4878>
4. Kryeministri Thaçi: Ne që të tre liderë të tri partive tona, të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së kemi arritur një marrëveshje për Kosovën e reformave, për Kosovën evropiane. Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Qasur më 21 maj 2015, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,1942>
5. U mbajt mbledhja konstituive e Komisionit për Ndryshime Kushtetuese. Kuvendi i Republikë së Kosovës. Qasur më 25 maj 2015, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,3689>
6. Telegrafi, ‘Zgjedhjet ‘kushtojnë’ 6.3 milionë euro’. Qasur më 26 qershor 2015,
<http://www.telegrafi.com/lajme/zgjedhjet-kushtojne-6-3-milione-euro-2-44718.html>
7. Ja çfarë thotë marrëveshja LDK-AAK-NISMA. Telegrafi. Qasur më 21 maj 2015.
<http://www.telegrafi.com/lajme/ja-çfare-thote-marreveshja-ldk-aak-nisma-2-46129.html>
8. Marrëveshja LAN – Vetëvendosje. Koha. Qasur më 21 maj 2015.
<http://koha.net/?id=27&l=24797>
9. Ja Marrëveshja e Plotë PDK- LDK. Kallxo.com. Qasur më 21 maj 2015,
<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Ja-Marreveshja-e-Plote-PDK-LDK-Dokument-3525>
10. Thaçi thotë se preferon të bëhet president përmes votës së popullit të Kosovës. Lajmi. Qasur më 21 maj 2015. <http://lajmi.net/thaci-thote-se-preferon-te-behet-president-me-voten-e-popullit-te->
11. Veseli: Do ta fitojmë garën për president,
<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=160544>

12. Deputeti i LDK-së Armend Zemaj, në prononcim për Rrokum TV, shih:
<http://rrokum.tv/3/zemaj-nese-thaci-bahet-president-me-vote-popullore-ldk-s039duhet-me-perkrahe-17140>.
13. Hashim Thaçi president në vitin 2016. Zëri. Qasur më 22 maj 2015,
<http://zeri.info/aktuale/21367/hashim-thaci-president-ne-vitin-2016-foto/>
14. Thaçi, president në të dy variantet. Lajmi.net. Qasur më 23 maj 2015, <http://lajmi.net/thaci-president-ne-te-dy-variantet/#sthash.ocmfJ6vP.dpuf>
15. Musmurati: Thaçi president ose prishet marrëveshja me LDK-në. RTK Live. Qasur më 22 maj 2015. <http://www.rtklive.com/?id=2&r=31288>
16. Bashkimi sipas tyre. Politiko. Qasur më 21 maj 2015. <http://politiko.net/bashkimi-sipas-tyre/#sthash.ybi3USvB.dpuf>
17. Grabovci: Prej popullit a prej Kuvendit Thaçi bëhet president. Gazeta Tribuna. Qasur më 28 maj 2015, <http://gazetatribuna.com/lajme/grabovci-prej-popullit-a-prej-kuvendit-thaci-behet-president/>
18. World Bulletin, “Si ndryshoi Turqia mënyrën sesi zgjedh presidentin e saj”. Qasur më 23 qershor 2015. <http://www.worldbulletin.net/turkish-presidential-elections/142283/how-turkey-changed-the-way-it-elects-its-president>

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

<p>ISBN</p>

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

